



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4504 .prot.

Gramsh, më 15/10/2024

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE  
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE  
(SPECIALIST)**

**Lloji i diplomës:** “Arkitekturë, Inxhineri”

**Niveli minimal i diplomës:** “Bachelor”

Në bazë të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu IV “pranimi në shërbimin civil” neni 21, neni 22, Kreu V “lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë” neni 25; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” Kreu II dhe Kreu VII; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institutcionet e Administratës Shtetërore dhe Institutcionet e Pavarura (ndryshuar VKM nr.305, datë 05.04.2017); Vendmit nr.09, datë 28.02.2024 “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil, për vitin 2024”, i ndryshuar me Vendimin nr. 62 date 10.10.2024 të Kryetarit të Bashkisë; Urdhërit nr.356, datë 14.10.2024 “Për shpallje vendesh të lira pune në administratën e Bashkisë Gramsh” të kryetarit të bashkisë, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive për grupin e posaçëm të pozicioneve:

**1. Specialist Hartim -Projektesh, kategoria IV;**

*Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË  
SHËRBIMIN CIVIL ) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për

**24.10.2024**

## LËVIZJE PARALELE:

Afati për dorëzimin e dokumentave për  
**PRANIM NË SHËRBIMIN  
CIVIL:**

**29.10.2024**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

1. **Specialist hartim projektsh:** Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Natyrore, kategoria IV, klasa IV-a; përgatit genplane duke azhornuar prona të qytetarëve, subjekteve private për leje ndërtimi, duke kryer azhornime në terren, për dhënie trualli me qera ose objektsh me qera. Kryen verifikimet në terren. Përditëson në mënyrë periodike në hartë të gjithë objektet me leje ndërtimi të miratuara. Kontrollon dhe mban përgjegjësi mbi të gjitha akt-kontrollet e fazave të ndërtimit; përgatit genplane duke azhornuar prona të qytetarëve, subjekteve private për leje ndërtimi, duke kryer azhornime në terren. Kryen verifikimet në terren. Përditëson në mënyrë periodike në hartë të gjithë objektet me leje ndërtimi të miratuara. Kontrollon dhe mban përgjegjësi mbi të gjitha akt-kontrollet e fazave të ndërtimit.

### 1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

1. Të jetë nëpunës i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori (ekzekutive) për të cilën aplikon;
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";
4. Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**



1. Të zotërojnë diplomë të nivelit **BACHELOR** -në shkencat Inxhinierike , për pozicionin e shpallur si me sipër;
2. Të ketë të paktën 1(një) vit pune në profesion;
3. Njohja e një gjuhe të vendeve të BE-së përbën avantazh;

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave (e noterizuar). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
8. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;
9. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 24.10.2024***

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **28/10/2024**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit [bashkiagramsh.gov.al](http://bashkiagramsh.gov.al), **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele** dhe kërkesat e posaçme, si dhe **datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.**

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË**

## ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e përgjithshme si dhe për specifikat e pozicionit të punës për të cilin do të konkurojnë:

1. Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”
3. Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”(i ndrshuar);
4. Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
5. Kodin e Procedurave Administrative;
6. Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
7. Ligjin 9367,date 07.04.2005 ”Për parandalimin e konfliktit interesit( i ndryshuar);
8. -Ligji nr.138/2015, date 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”
9. Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .

### Specialist Hartim-Projektsh, kategoria IV;

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014, datë 08.09.2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
2. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, date 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
3. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8116, date 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Njohuri Mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, etj.
5. Njohuritë mbi ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
6. Njohuritë mbi ligjin nr.162/2020“Për prokurimin publik”
7. VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021).

## 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për pervojen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2,



datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”  
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në **08.11.2024**. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mailit).

## **2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e të Bashkisë Gramsh, Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe standën e Njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, duke filluar nga data **08.11.2024**

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedure kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” (I ndryshuar).

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

1. Të jetë shtetas shqipëtar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
7. Të plotësojë kërkesat e posacme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posacme për kategorinë, klasën grupin dhe pozicionet përkatëse;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “**BACHELOR**” -në shkencat Inxhinierike për pozicionin **Specialist Hartim-Projktesh;**
2. Të ketë të paktën 1(një) vit pune në profesion;



3. Njohja e një gjuhe të vendeve të BE-së përbën avantazh;

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vacant;
2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitiv apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates **29.10.2024***

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **04.11.2024**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit [bashkiagramsh.gov.al](http://bashkiagramsh.gov.al), **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimin në shërbimin civil dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.**

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimin në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e vecanta, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e përgjithshme si dhe për specifikat e pozicionit të punës për të cilin do të konkurojnë:

1. Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”
3. Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”(i ndrushuar);
4. Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
5. Kodin e Proedurave Administrative;
6. Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
7. Ligjin 9367,date 07.04.2005 ”Për parandalimin e konfliktit interesit( i ndrushuar);
8. -Ligji nr.138/2015, date 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojne funksione publike”
9. Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .

**Specialist Hartim-Projektsh, kategoria IV, Klasa IV-a;**

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014, datë 08.09.2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndrushuar.
2. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, date 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
3. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8116, date 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndrushuar.
4. Njohuri Mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndrushuar, etj.
5. Njohuritë mbi ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
6. Njohuritë mbi ligjin nr.162/2020“Për prokurimin publik”
7. VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021).

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratet dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratet dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>



2.6

## DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

### Lista e fituesve me mbi 70(shtatëdhjetë) pikë do të shpallet në datën 21.11.2024

Njoftimi do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Afati për ankim është 3 (tre) ditë duke filluar nga data 21.11.2024.

Njësia përgjegjëse, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues ose me më pak fitues se planifikimi, rihap procedurën e pranimit në shërbimin civil, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga përfundimi i shqyrtimit të akimeve.

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**

